L I G J
Nr. 8968, datë 7.11.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8560, DATË 22.12.1999, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 8710, DATË 15.12.2000 DHE NR. 8846, DATË 11.12.2001

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 8710, datë 15.12.2000 dhe nr. 8846, datë 11.12.2001, paragrafi i dytë i nenit 19 ndryshohet si vijon:

"Përjashtimisht për vitet 2002 dhe 2003, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve autorizohet të përdorë 2 për qind të shumës vjetore të tatimeve të mbledhura gjatë vitit. Nga kjo shumë, 60 për qind përdoren për investime në modernizimin e administratës tatimore dhe pjesa tjetër për shpenzime korrente për shpërblimin e punonjësve dhe fonde operative."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3585, datë 4.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu